

Ndërveprimi midis mbikëqyrësve të sektorit financiar, audituesve dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse

Pascal Frerejacque, Nëpunës i lartë për operacionet, CFRR, Banka Botërore

24 tetor 2017, Vjenë

Ecja përpara në rregullimin e kontabilitetit & auditimit: përmirësimi i përputhshmërisë nëpërmjet kontrollit më të mirë të zbatimit dhe kërkesave adekuatë për raportimin jofinanciar

CFRR

**Centre for Financial
Reporting Reform**



Strengthening Auditing and Reporting in
the Countries of the Eastern Partnership



Road to Europe: Program of Accounting Reform
and Institutional Strengthening

This event is co-funded by:

 Austrian
Development Cooperation



 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra




**European
Union**

 LE GOUVERNEMENT
DU GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG
Ministère des Finances

Hyrje: një angazhim efektiv

“Aktualisht po përfitojmë nga një investim i gjatë në marrëdhëniet midis mbikëqyrësve dhe audituesve:




Kemi investuar shumë në këtë strukturë komunikimi prej më shumë se 10 vjetësh dhe jemi të sigurt se duhet të vijojmë të investojmë.” -- Vendet e Ulëta

Një vështirësi kryesore: gjetja e ekuilibrit të duhur



Vështrim i përgjithshëm mbi publikimet më kryesore



Deklarim mospërgjegjësie

1. Veprimet janë sugjerime/praktika të mira të raportuara dhe nuk janë shteruese
2. Mbikëqyrësit dhe audituesit e jashtëm të mbajnë parasysh edhe që:
 - a) Veprimet **nuk i ndryshojnë rolet dhe përgjegjësitë e entit** mbikëqyrës, audituesit të jashtëm ose administratorëve të bankës.
 - b) Veprimet nuk zëvendësojnë SNA-të, SNRF-të, praktikat më të mira ndërkombëtare për drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare apo parimet e njohura botërisht (IOSCO, Basel, AESPMP, BSNAS etj.) sidomos në fushat e pavarësisë dhe llogaridhënies të audituesve të jashtëm dhe administratorëve të bankës.
 - c) Objektivat kryesorë të veprimeve janë:
 - i. **Rritja ose fuqizimi i komunikimit dhe ndërveprimit** midis mbikëqyrësve dhe audituesve;
 - ii. **Sigurimi** që ndërveprimi midis mbikëqyrësve dhe audituesve të jashtëm të jetë **i vazhdueshëm dhe të bëhet në mënyrë sistematike dhe të strukturuar**;
 - iii. **Mbajtja** e një marrëdhënieje mbikëqyrës-auditues e cila është **kritike por edhe konstruktive**;
 - iv. **Sigurimi i një baze** për mirëkuptim reciprok më të mirë dhe më të hollësishëm të çështjeve dhe risqeve në sektorët e mbikëqyrur; dhe
 - v. **Përforcimi i proceseve mbikëqyrëse dhe audituese.**

Burimi i informacionit

PARTICIPATION OF 35 COUNTRIES ACROSS EUROPE AND CENTRAL ASIA



44
questions to
supervisors

35
countries
in ECA

85%
responses
rate

Udhëzues: informacione

Auditimi i jashtëm



Puna e audituesve kontribuon në mbikëqyrje efektive

Channels of Communication



Mbikëqyrësit mund të angazhohen më me efektivitet me audituesit e jashtëm

Topics of Mutual Interest



Audituesit e jashtëm mund të kontribuojnë më shumë në fushat me interes për mbikëqyrësit

Supervisors' Input to Audits



Mbikëqyrësit kontribuojnë në rritjen e cilësisë së auditimit

Other Communication



Komunikimi efektiv midis mbikëqyrësve të auditimit / subjekteve komiteteve të auditimit e përmirëson cilësinë e auditimit

Diagnostikim i shkurtër i vendeve: KNF Poloni

Auditimi i jashtëm

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të përkthyer nga Autoriteti i Mbikëqyrjes (KIBR) zbatohen
- Mbikëqyrësit kanë të drejtë shikimi të raporteve të auditimit
- Audituesit e jashtëm detyrohen me ligj të raportojnë mashtrimet me rëndësi materiale dhe konstatimet e tjera me rëndësi (gabime, dobësi të kontrollit të brendshëm)
- Mbikëqyrësit nuk mund t'u kërkojnë audituesve të kryejnë detyra jashtë objektit të auditimit në mënyrë që të kontribuojnë në punën rregullatore

Kanalet e komunikimit

- Nuk ka qasje proporcionale në komunikimin me audituesit
- Kryhen takime trepalëshe dhe dypalëshe, plus takime që përfshijnë komunitetin e auditimit, gjithmonë pas nxjerrjes së opinionit të auditimit (takim normalisht një herë në vit por çështjet me rëndësi për sistemin diskutohen në mënyrë ad hoc). Ka një përzierje të kanaleve formale dhe joformale të komunikimit
- Nuk ka sistem marrjesh mendimesh dhe sugjerimesh.

Temat me interes reciprok

- Nuk bëhen diskutime me audituesit për strategjinë dhe planin e auditimit. Strategjia e auditimit nuk i përcillet mbikëqyrësit
- Vlerësimi dhe provigjionimi i kredive, vlerësimi i aktiveve të bankës, menaxhimi i riskut, pasqyrat financiare vjetore, efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sigurimi i bankës zakonisht diskutohen. (Nuk është gjë e zakonshme të diskutohet për komitetin e auditimit dhe letrën e administratorëve)
- Audituesit auditojnë disa deklarata të makrombikëqyrjes (raporti i aftësisë paguese) por jo rakordin e pasqyrave financiare të audituara me elemente të kapitalit mbikëqyrës

Kontributi i mbikëqyrësve për auditimet

- Nuk ka kufizim ligjor lidhur me informacionin që mbikëqyrësit mund t'u japin audituesve të jashtëm
- Nuk ka rol mbikëqyrës në emërimin fillestar të audituesve të jashtëm (nuk ka aq kritere specifike për emërimin e audituesve të jashtëm të bankave)
- Nuk ka rotacion të detyrueshëm ose ritenderim të firmës së auditimit (pra rotacioni pas 5 vjetësh kërkohet vetëm partnerin kryesor auditues)

Komunikime të tjera

- Ka një sistem të organit të mbikëqyrjes publike (KIBR dhe KKN) dhe një anëtar i UKNF është në strukturën e KIBR. Ka edhe një sistem të kontrollit të cilësisë. Zakonisht takohen më shumë se një herë në vit me mbikëqyrësin.
- Komiteti i auditimit kërkohet vetëm për bankat e nivelit të dytë. Mblidhet të paktën një herë në vit, ose ad hoc.

Auditimi i jashtëm



**Puna e
audituesve
kontribuon
në mbikëqyrje
efektive**

- » Mbikëqyrësit dhe audituesit e jashtëm: shprehi dhe njohuri plotësuese
- » Pasqyrat financiare: kontribut i rëndësishëm për mbikëqyrjen (më shumë besim në deklaratat e makrombikëqyrjes përmes rakordimit me pasqyrat financiare të audituara)
- » Audituesit e jashtëm mund të marrin pjesë në procesin e mbikëqyrjes duke dhënë siguri të arsyeshme ose të kufizuar për një gamë fushash me kërkesën e mbikëqyrësve:
 - » Sistemet e kontrollit të brendshëm
 - » Sistemet informatike
 - » Administrimi i riskut
 - » Raportet e makrombikëqyrjes
- » **Raportimi i audituesit të jashtëm ndihmon në fuqizimin e procesit të mbikëqyrjes**



**Puna e
audituesve
kontribuon
në mbikëqyrje
efektive**

Kapaciteti i mbikëqyrësve

Probleme të zakonshme

Mbikëqyrësit përballen me kufizime në kapacitete sa i takon personelit dhe trajnimit në kontabilitet dhe auditim.

Mbikëqyrësit jo gjithmonë e kuptojnë mirë se në çfarë konsiston auditimi i jashtëm dhe si mund të mbështeten në punën e audituesve.

Masa të mundshme

Ofrim i trajnimit në vazhdimësi për SNA dhe SNRF stafit të autoritetit të mbikëqyrjes.

Shembuj të praktikave më të mira

Autoriteti i Makrombikëqyrjes (PRA) i Mbretërisë së Bashkuar përpiqet të ofrojë trajnim më të rregullt për mbikëqyrësit lidhur me angazhimin auditues-mbikëqyrës, me fokus te mënyra se si mund të kuptohet më mirë puna e audituesve si edhe duke nxitur një dialog më të hapur dhe më të thellë.



**Puna e
audituesve
kontribuon
në mbikëqyrje
efektive**

Shkalla e përdorimit të audituesve të jashtëm

Probleme të zakonshme

Shumica e mbikëqyrësve evropianë mund t'u kërkojnë audituesve të jashtëm të kryejnë detyra shtesë jashtë objektit të auditimit. Por, praktikat ndryshojnë në mbarë EAQ sa i takon objektit të punës së audituesve, shkallës së kontributeve të audituesve në procesin mbikëqyrës dhe llojit të sigurimit të ofrojnë.

Masa të mundshme

Shkëmbimi i informacionit me audituesit e jashtëm në mënyrë të vazhdueshme dhe përpara planifikimit të auditimit ligjor.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Irlandë, Ligji i Bankës Qendrore (2013) ka një dispozitë për Bankën Qendrore e cila mund t'u kërkojë audituesve të jashtëm të japin siguri për fushat lidhur me: 1) procedurat administrative ose kontabël, 2) mekanizmat e kontrollit të brendshëm, 3) administrimin e riskut, 4) strukturën organizative dhe 5) drejtimin e brendshëm të ofruesve të shërbimeve financiare të rregulluara.



**Puna e
audituesve
kontribuon
në mbikëqyrje
efektive**

Raporti i gjatë i auditimit

Probleme të zakonshme

Aktualisht, shumë pak mbikëqyrës kërkojnë raport auditimi në formë të gjatë nga audituesit e jashtë.

Masa të mundshme

Kërkim i raportit të gjatë për SIB.

Objekti dhe përmbajtja e raportit të gjatë: fleksibël, i vendosur bashkërisht, përfshin metodikën/kufizimet e auditimit, konstatimet për vijimin e biznesit/risqet, dhe masat korrigjuese të rekomanduara.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Austri, sipas ligjit austriak për bankat, audituesit e jashtëm të bankave janë të detyruar të auditojnë një shtojcë shtesë (raporti i makrombikëqyrjes) së bashku me auditimin e pasqyrave financiare.



**Puna e
audituesve
kontribuon
në mbikëqyrje
efektive**

Detyrimi dhe e drejta për raportim

Probleme të zakonshme

Audituesit e jashtëm nuk e kanë gjithmonë detyrimin ligjor për të raportuar konstatime të rëndësishme dhe mashtrim gjatë auditimit. Gjithashtu, disa vende parashikojnë rregulla që i mbrojnë audituesit kur ushtrojnë të drejtën për të raportuar konstatimet.

Masa të mundshme

Përditësimi i rregulloreve: krijimi i rregullave mbrojtëse.

Kërkimi i të drejtës së shikimit për të gjitha llojet e informacioneve nga auditimi me rëndësi për mbikëqyrjen.

Shembuj të praktikave më të mira


Në Maqedoni, firma e auditimit duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Guvernatorin nëse gjatë auditimit konstaton se aftësia paguese ose likuiditeti i bankës komprometohet dhe banka ushtron ose ka ushtruar aktivitet në kundërshtim me rregulloret. Kjo kërkesë zbatohet edhe për subjektet juridike me të cilat banka ka lidhje të ngushta.

Kanalet e komunikimit



Mbikëqyrësit
mund të
angazhohen
më
me efektivitet
me audituesit e
jashtëm

- » Shkëmbimet e rregullta të informacionit u japin mundësi të dyja palëve t'i kryejnë më me efikasitet detyrat e tyre
- » Një marrëdhënie e fortë dhe frytshme varet nga “cilësia” e ndërveprimit



*“diskutimi duhur në
nivelin e duhur dhe në
momentin e duhur”
duke përdorur kanalet
më të përshtatshme të
komunikimit*



Mbikëqyrësit mund të angazhohen më me efektivitet me audituesit e jashtëm

Qasja proporcionale e bazuar në risk

Probleme të zakonshme

Jo të gjithë mbikëqyrësit përdorin një qasje proporcionale të bazuar në risk kur komunikojnë me audituesit e jashtë.

Masa të mundshme

Zhvillimi i kriterëve të duhura për përcaktimin e subjekteve me rëndësi për sistemin.
Organizimi i diskutimeve më të shumta dhe të hershme me audituesit e jashtëm të këtyre subjekteve.

Kryerja e takimeve me kryetarët e komiteteve të auditimit të këtyre subjekteve.

Shembuj të praktikave më të mira

Banka Kombëtare e Belgjikës (BKB) ndjek një qasje proporcionale në ndërveprimin me audituesit e jashtëm në bazë të profilit të riskut të bankës, madhësisë dhe nëse e ka zyrën qendrore në Belgjikë ose jo. Një sërë kriteresh përcakton bankat me rëndësi për sistemin (BRS). Bëhen takime me BRS çdo tremujor (1 herë në vit për bankat jo BRS), me personelin më të lartë të BKB-së. BKB u dërgon një kopje të shumicës së komunikimeve midis BKB-së dhe bankës auditueseve të jashtëm.



**Mbikëqyrësit
mund të
angazhohen
me
me efektivitet
me audituesit e
jashtëm**

Koha dhe shpeshtësia e raportimit

Probleme të zakonshme

Ndërkohë që shumica e mbikëqyrësve përmendin mundësinë për të pasur takime ad hoc me audituesit e jashtëm, në përgjithësi ata komunikojnë me audituesit e jashtëm vetëm pasi ka dalë opinionit i auditimit.

Masa të mundshme

Përcaktimi i përbashkët i detyrës dhe objektit të marrëdhënies.

Takim dhe shkëmbim informacioni më herët dhe më rregullisht brenda procesit të auditimit. Takimet në fazën e planifikimit dhe përpara daljes së opinionit të auditimit.

Bërja e takimeve/kontakteve ad hoc.

Mbajtja fleksibilitetit dhe shmangia e rutinës.

Shembuj të praktikave më të mira

Banka Kombëtare e Vendeve të Ulëta (BKVU) ka filluar të bëjë takime trepalëshe dy herë në vit për bankat e mëdha dhe një herë në vit për bankat e tjera (me përjashtim të bankave të vogla). BKVU takohet 3 herë në vit edhe me komitetet e sektorit financiar të Shoqatës Holandeze të Kontabilistëve (NBA) dhe me drejtuesit e lartë të firmave të auditimit (4 të mëdhatë) në nivel nënsektori (bankat, siguruesit dhe fondet e pensione). Ata takohen edhe me këshillin e BKVU-së 1 herë në vit për të diskutuar për çështje me natyrë strategjike.



**Mbikëqyrësit
mund të
angazhohen
më
me efektivitet
me audituesit e
jashtëm**

Kanalet e komunikimit

Probleme të zakonshme

Në përgjithësi, mbikëqyrësit ose përdorin kanale formale ose, përdorin njësoj si kanalet formale ashtu edhe ato joformale të komunikimit me audituesit e jashtëm.

Masa të mundshme

Përdorimi sipas rastit: kanale formale/joformale, me gojë ose me shkrim; takime ad hoc/të strukturuar

Mbajtësit parësorë të marrëdhënies, kolegë dhe punonjës të ekipeve përkatëse dhe/ose ekspertë.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Danimarkë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (FSA) merr një raport të gjatë nga audituesit e jashtëm çdo vit, ndërsa audituesit e jashtëm marrin një kopje të pjesës më të madhe të komunikimit midis bankës dhe FSA-së daneze.



**Mbikëqyrësit
mund të
angazhohen
më
me efektivitet
me audituesit e
jashtëm**

Procesi i reagimit me mendime dhe sugjerime

Probleme të zakonshme

Shumica e mbikëqyrësve nuk kanë një sistem për marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve në mënyrë që të vlerësojnë e marrëdhënies me audituesit e jashtëm. Edhe kur ka një proces të marrjes së mendimeve, në përgjithësi ky është joformal.

Masa të mundshme

Ngritja e një procesi të marrjes së mendimeve dhe përdorimi i tij për të monitoruar cilësinë e dialogut dhe për të vlerësuar praktikatat ekzistuese.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Mbretërinë e Bashkuar, Këshilli i Autoritetit të Rregullimit Makrombikëqyrës (PRA) ka bërë një anketë elektronike të mbikëqyrësve të firmave më të mëdha për: 1) shpeshtësinë dhe kohën e takimeve të parashikuara ose formale auditues-mbikëqyrës; 2) cilësinë e këtyre takimeve dhe 3) nëse marrëdhënia më e gjerë ka qenë e tillë që mbikëqyrësit besojnë se audituesit do t'i kontaktonin paraprakisht, në mënyrë joformale jashtë takimeve të parashikuara për të bërë të ditura shqetësimet e reja.

Temat me interes reciprok



Audituesit e jashtëm mund të kontribuojnë më shumë në fushat me interes për mbikëqyrësit

- » Ka tema të shumta me interes reciprok për mbikëqyrësit dhe audituesit, kryesisht për shkak të kompleksitetit, rëndësisë materiale ose subjektivitetit
- » Mbikëqyrësit kanë shumë pak informacion për aktivitetet e komiteteve të auditimit

Standardet e kontabilitetit



- Temat e mbuluara nga SNA 39 ose SNRF 9, si vlerësimi dhe provigjionimi i kredive, si edhe vlerësimi i aktiveve, janë me rëndësi për mbikëqyrësit

Vjedisi i risqeve dhe i masave kontrolluese



- Efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm, administrimit të risqeve dhe sistemit informatik janë faktorë me rëndësi kryesore në vlerësimin e profilit të riskut dhe supozimit të vijmësisë

Informacioni i makrombikëqyrjes



- Përputhshmëria me rregulloret e makrombikëqyrjes dhe njëtrajtshmëria e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare me informacion të publikuar të makrombikëqyrjes



Audituesit e jashtëm mund të kontribuojnë më shumë në fushat me interes për mbikëqyrësit

Planifikimi dhe ecuria e auditimit

Probleme të zakonshme

Shumë pak mbikëqyrës diskutojnë për strategjinë dhe planin e auditimit me audituesit e jashtëm. Ndryshimet e këtyre planeve nuk u komunikohen sistematikisht mbikëqyrësve.

Masa të mundshme

Diskutimi me audituesit e jashtëm për fushat që mund të ndikojnë në strategjinë e auditimit.

Përdorimi i strategjisë dhe planit të auditimit si kontribut në planin e punës mbikëqyrëse.
Kërkesa dhe diskutimi i planit dhe strategjisë së auditimit për njësitë ekonomike me rëndësi për sistemin.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Kroaci, firma e auditimit duhet t'i japë planin vjetor të auditimit për çdo institucion kreditimi Bankës Kombëtare Kroate, duke treguar fushat e fokusit, metodikën e auditimit si edhe kohëzgjatjen e parashikuar të auditimit.



Audituesit e jashtëm mund të kontribuojnë më shumë në fushat me interes për mbikëqyrësit

Politikat kontabël

Probleme të zakonshme

Vlerësimi i kredive dhe provigjionimi i humbjes së kredive dhe, më në përgjithësi, vlerësimi i aktiveve të bankës dhe efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm kanë qenë tema me interes për mbikëqyrësit për t'i diskutuar me audituesit e jashtëm.

Masa të mundshme

Diskutimi me audituesit e jashtëm për proceset për të marrë njohuri të hollësishme për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për supozimet e përdorura në procesin e vlerësimit për të siguruar që mbikëqyrësit të mud të vlerësojnë në mënyrë kritike nëse ky sistem është aktual, i besueshëm dhe përdoret në mënyrë të njëtrajtshme.

Shembuj të praktikave më të mira

Enti rregullator francez ofron një listë temash të mundshme për diskutim: tema të kontabilitetit (p.sh.: zbatimi i standardeve të reja, shqyrtimi i çmuarjeve kontabël me rëndësi); tema jo të përsëritura (p.sh.: probabiliteti i dhënies së një opinioni me rezerva); komitetet e auditimit (p.sh.: pikat kryesore që do t'i komunikohen komitetit të auditimit); tema të tjera të mundshme diskutimi (p.sh.: dëshmitë e mosfunksionimit të masave kontrolluese).



Audituesit e jashtëm mund të kontribuojnë më shumë në fushat me interes për mbikëqyrësit

Raportet e makrombikëqyrjes

Probleme të zakonshme

Rakordimi midis elementeve të kapitalit të rregulluar dhe pasqyrave financiare të audituara shpesh nuk është objekt i auditimit. Raportet e makrombikëqyrjes shpesh nuk shqyrtohen nga audituesit.

Masa të mundshme

U kërkohet audituesve të jashtëm të shqyrtojnë rakordin e fondeve të veta të detyrueshme me kapitalin kontabël.

U kërkohet audituesve të jashtëm të shqyrtojnë dhe vlerësojnë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike për përgatitjen e raporteve të makrombikëqyrjes në sistemin e raportimit rregulator.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Spanjë, audituesve të jashtëm u kërkohet të kontrollojnë përputhjen e shifrave kontabël që gjenden në disa raporte të caktuara të makrombikëqyrjes me regjistrat kontabël të shqyrtuar brenda objektit të auditimit dhe në disa raste ta përfshijnë këtë në raportin e gjatë.

Kontributi i mbikëqyrësve për auditimet



**Mbikëqyrësit
kontribuojnë
në rritjen e
cilësisë së
auditimit**

- » Mbikëqyrësit mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së informacionit financiar në mënyra të ndryshme:
 - » Ata mund të sigurojnë një mjedis që mbështet pavarësinë, objektivitetin dhe integritetin e punës së auditimit
 - » Ata mund të rregullojnë disa kushte të caktuara lidhur me emërimin dhe rotacionin e audituesve të jashtëm dhe ritenderimin e auditimit si edhe monitorimin dhe sanksionimin e audituesve dhe punës së tyre
 - » Ata mund ta rrisin cilësinë e auditimit duke u dhënë audituesve të jashtëm informacion përkatës

Kontributi i mbikëqyrësve për auditimet



**Mbikëqyrësit
kontribuojnë
në rritjen e
cilësisë së
auditimit**

Shkëmbimi i informacionit: nga mbikëqyrësit te audituesit

Probleme të zakonshme

Rregullat e ruajtjes së fshehtësisë së informacionit mund t'i pengojnë mbikëqyrësit që të ndajnë informacion me audituesit e jashtëm, gjë e cila mund të ketë ndikim negativ te mbikëqyrja.

Masa të mundshme

Krijimi i rregullave «të portës» për të lejuar shkëmbimin e informacionit me audituesit e jashtëm. Ky informacion mund të jetë specifik për njësinë ekonomike, specifik për sektorin e ekonomisë dhe mund të lidhet me risqet e mëparshme dhe ato të reja. Objektivi është që të ndihmohen audituesit të bëjnë një auditim më cilësor, gjë e cila nga ana e vet mund të kontribuojë në procesin e mbikëqyrjes.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Vendet e Ulëta, mbikëqyrësve ua lejon ligji të ndajnë informacion me audituesit e jashtëm, por nuk e kanë për detyrim. Ndonjëherë kur u jepen audituesve informacione delikate mund të rrezikohen «zgjidhjet». Në raste të tilla mbikëqyrësit nuk u japin audituesve informacione delikate. Por nëse informacioni ka ose mund të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në opinionin e audituesit, mbikëqyrësi ua jep këtë informacion audituesve të jashtëm.

Kontributi i mbikëqyrësve për auditimet



Mbikëqyrësit
kontribuojnë
në rritjen e
cilësisë së
auditimit

Emërimet e audituesve të jashtëm

Probleme të zakonshme

Shumica e mbikëqyrësve evropianë e kanë ndonjë formë përgjegjësie për kontroll mbikëqyrës mbi emërimin e audituesve të jashtëm (e drejta e parazgjedhjes, miratimi/largimi ose porpositja e një auditimi të pavarur). Por përgjegjësitë e mbikëqyrësve ndryshojnë nga vendi në vend.

Masa të mundshme

Ngritja e një kuadri të mbështetur në parime.

Sigurimi që procesi për emërimin e audituesit të jashtëm të jetë i drejtë, objektiv, transparent, i pavarur nga administratorët e shoqërisë dhe i dokumentuar mirë.

Shqyrtimi dhe monitorimi rregullisht i kushteve të emërimit të audituesit të jashtëm.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Danimarkë, audituesit e jashtëm të bankave janë të detyruar të certifikohen nga FSA danez.

Mes kriterëve të tjera, ata duhet të dëshmojnë se kanë kryer të paktën 1.500 orë punë me pagesë në auditimin e institucioneve financiare brenda 5 viteve të fundit. Nga këto orë të pagueshme, 1.000 duhet të përfshijnë shërbime auditimi të paktën të 3 bankave. Të gjitha këto orë duhen realizuar pasi të jenë autorizuar nga një kontabilist publik shtetëror dhe 50% e tyre si auditues nënshkrues ose drejtues ekipi.

Kontributi i mbikëqyrësve për auditimet



Mbikëqyrësit
kontribuojnë
në rritjen e
cilësisë së
auditimit

Rotacioni i firmës së auditimit dhe ritenderimi

Probleme të zakonshme

Rezultatet tregojnë se rotacioni i detyrueshëm i firmave të auditimit ndodh rrallë ndërsa shumica e mbikëqyrësve aktualisht kërkojnë me forcë zbatimin e rotacionit të detyrueshëm të partnerëve kryesorë të auditimit.

Në shumicën e vendeve, i njëjti auditues i jashtëm mund të riemërohet pa kaluar në procesin e detyrueshëm të tenderimit.

Masa të mundshme

Ngritja e një kuadri për rotacionin e audituesve të jashtëm në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare për të siguruar pavarësinë dhe për të shmangur konfliktin e interesit. Kërkimi i përdorimit të kriterëve të duhura për përzgjedhjen e partnerit kryesor të auditimit nga palët përkatëse.

Shembuj të praktikave më të mira

Në BE, prej muajit qershor 2016, njësitë ekonomike me interes publik (NJEIP) janë të detyruara t'i ndryshojnë firmat e auditimit pas një mandati prej maksimumi 10 vjetësh. Mandati 10-vjeçar mund të zgjatet me 10 vjet të tjerë nëse kryhet tender dhe deri në 14 vjet të tjerë në rast auditimi të përbashkët. Ekziston mundësia të përdoren periudha më të shkurtra rotacioni. Partnerët kryesorë të auditimit të NJEIP-ve duhet të bëjnë rotacion të paktën çdo 7 vjet me periudhë largim prej 3 vjetësh.

Komunikime të tjera



Komunikimi
efektiv midis
mbikëqyrësve
të auditimit /
subjekteve
komiteteve të
auditimit e
përmirëson
cilësinë e
auditimit

- » KA dhe OMA kontribuojnë në rritjen e cilësisë së auditimit përmes mbikëqyrjes efektive të punës së audituesve të jashtëm dhe aftësisë së tyre për të formuar një opinion për pasqyrat financiare të njësisë ekonomike:
 - » KA këshillon për emërimin e audituesit të jashtëm dhe vlerëson efektivitetin e punës së tij
 - » OMA synon të identifikojë mosfunksionimin dhe pikat e dobëta në auditimet e jashtme të njësisë ekonomike dhe të këqyrë punën e audituesve të jashtëm, duke vendosur sanksione dhe/ose masa korigjuese sipas nevojës
- » Të dy luajnë rol kritik në ngritjen e një kuadri të duhur për drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe për auditime të jashtme cilësore



Komunikimi
efektiv midis
mbikëqyrësve
të auditimit /
subjekteve
komiteteve të
auditimit e
përmirëson
cilësinë e
auditimit

Marrëdhënia midis mbikëqyrësve dhe OMA-ve

Probleme të zakonshme

Megjithëse shumica e mbikëqyrësve kanë linja komunikimi me OMA-të, shpeshtësia e takimeve dhe komunikimit me OMA-të ndryshon nga vendi në vend.

Masa të mundshme

Nënshkrimi i një aktmarrëveshjeje midis OMA-së dhe autoritetit mbikëqyrës.

Takimi me OMA në mënyrë të rregullt pa penguar takimet ad hoc.

Shembuj të praktikave më të mira

Sipas Direktivës së BE-së për auditimin ligjor, sistemet e mbikëqyrjes publike do të kenë përgjegjësinë e fundme për mbikëqyrjen e: miratimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit; miratimit të standardeve për etikën, kontrollin e brendshëm të cilësisë së firmave të auditimit dhe auditimin; edukimin e vazhdueshëm, kontrollin e cilësisë; sistemeve hetimore dhe disiplinore.



Koncepti i efektiv midis mbikëqyrësve të auditimit / subjekteve komiteteve të auditimit e përmirëson cilësinë e auditimit

Organet e mbikëqyrjes së auditimit & kontrolli i cilësisë

Probleme të zakonshme

Në shumë vende, organizata profesionale për audituesit është përgjegjëse për kontrollin e cilësisë. Në BE, një autoritet i vetëm kompetent do të hartohet për të mbajtur përgjegjësinë e fundme për sistemin e mbikëqyrjes publike të audituesve (i detyrueshëm prej vitit 2016).

Masa të mundshme

Kërkimi i zbatimi të mjeteve, metodikave dhe shprehive të duhura për mbikëqyrjen publike dhe kontrollin e cilësisë në vendet përkatëse. Kjo përfshin kriteret për trajnimin e vazhdueshëm dhe njohuritë në SNRF dhe SNA, sipas rastit.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Republikën Çeke, sistemi i kontrollit të cilësisë së auditimit: do të jetë i pavarur, do të jetë objekt i mbikëqyrjes publike, do të ketë financim të sigurt, do të kryhet nga një person fizik i pavarur nga audituesit e kontrolluar dhe me arsim dhe përvojë të mjaftueshme profesionale në fushën e auditimeve ligjore dhe raportimit kontabël (pra që ka marrë trajnimet e specializuara të përcaktuara nga Dhoma) dhe do të kryhet të paktën një herë në tre vjet për audituesit e bankave.



Komitetet e auditimit
efektiv midis
mbikëqyrësve
të auditimit /
subjekteve
komiteteve të
auditimit e
përmirëson
cilësinë e
auditimit

Komitetet e auditimit

Probleme të zakonshme

Roli dhe përgjegjësitë, si edhe kapaciteti, i komiteteve të auditimit ndryshon në rajonin e EAQ-së. Në disa vende, nuk kërkohet me ligj të ketë komitete auditimi për bankat.

Masa të mundshme

Kërkimi që bankat të kenë komitet auditimi.

Promovimi i komiteteve efektive të auditimit, me anëtarë që janë të pavarur dhe që kanë shprehitë e duhura.

Takimi me kryetarët e komiteteve të auditimit të BRS-ve.

Shembuj të praktikave më të mira

Në Slloveni, komitetet e auditimit monitorojnë efektivitetin e procesit të administrimit të riskut, funksionet e auditimit të brendshëm dhe kontrollit të brendshëm dhe shqyrtojnë procedurat kontabël të bankës.

The background is a solid green color with a complex, low-poly geometric pattern. The pattern consists of numerous irregular polygons of varying sizes and shades of green, creating a textured, crystalline effect. The text is centered in the middle of the image.

FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN